



*Kuvendi i Komunës Klinë*

*01Nr prot. 06 - 3902/2025*

*Datë: 05.02/2025*

*Duke u mbështetur në nenin 17 shkronjën s), nenin 39 paragrafi 7, nenin 40. Paragrafi 40.2 shkronjën c) shkronjën e) dhe shkronjën l) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale 03/L-040 si dhe nenin 35 të Ligjit Nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik nenit 40 paragrafi 2 piken 5) të Statutit të Komunës së Klinës si dhe vendimit për formimin e komisionit për zgjedhjen e këshillave lokal të miratuar me datë 28.01.2022, Kuvendi i Komunës së Klinës në seancën e I-rë të rregullt për vitin 2025 të mbajtur me datën 31.01.2025, mori këtë:*

## V E N D I M

### *Për pagesën e Komisionit për zgjedhjen e Këshillave Lokal*

1. Miratohet propozimi i Ekzekutivit të Komunës së Klinës për pagesën e Komisionit për zgjedhjen e Këshillave Lokal.
2. Anëtarët e Komisionit të cilët janë emëruar me Vendim të Kuvendit, për punën e tyre do të kompensohen në shumë prej 50 (pesëdhjetë euro) për çdo pjesëmarrje në zgjedhjen e çdo Këshilli Lokal.
3. Për dallim nga anëtarët e tjerë të Komisionit, anëtari i Komisionit i cili vije nga lokaliteti ku është zgjedhur Këshilli Lokal do të kompensohet vetëm për 1 mbledhje.
4. Kompensimi i anëtareve të komisionit do të bëhet nga kategoria Mallra dhe Shërbime, nga programi Drejtoria e Financave (17518)
5. Për ekzekutimin e këtij Vendimi obligohet Kryetari i Komunës në bashkëpunim me Drejtorin për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim.
6. Vendimi hyn në fuqi pas miratimit nga Kuvendi i Komunës, bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore të cilat janë në fuqi dhe pas publikimit në web faqen zyrtare të komunës.

### Me këtë vendim njoftohen:

- MAPL;
- Kryetari i Komunës;
- Drejtoria për Financa, Ekonomi dhe Zhvillim;
- Zyra për Informim;
- Arkivi.



Kryesues i Kuvendit  
Fadil Gashi